VENDIM
Nr. 675, datë 28.9.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E SISTEMIT TË GJURMIMIT DHE TË IDENTIFIKIMIT TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse për përdorim civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe të procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe të identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Subjektet tregtare në fushën e lëndëve plasëse për përdorim civil duhet të ngrenë sistemin e gjurmimit dhe të marrin masa për zbatimin e neneve 3, pikat 6, 13 dhe 14, të tekstit bashkëlidhur këtij vendimit, brenda një viti nga hyrja në fuqi e tij.
3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

RREGULLA DHE PROCEDURA
PËR KRIJIMIN E SISTEMIT TË GJURMIMIT DHE TË IDENTIFIKIMIT TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtyre rregullave dhe procedurave është ngritja e një sistemi të harmonizuar për identifikimin unik dhe gjurmueshmërinë e lëndëve plasëse për përdorim civil.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Këto rregulla dhe procedura zbatohen për të gjitha lëndët plasëse për përdorim civil, që prodhohen/importohen/eksportohen në Repu-blikën e Shqipërisë.
2. Këto rregulla dhe procedura nuk zbatohen, për:

a) lëndët plasëse për përdorim civil që transportohen dhe shpërndahen të paambalazhuara ose në autopompa, me qëllim shkarkimin e tyre direkt në vendin e shpërthimit;

b) lëndët plasëse për përdorim civil të prodhuara në vendin ku do të realizohet shpër-thimi, të cilat përdoren po atje, menjëherë pas prodhimit;

c) municionet;

ç) ndezës të sigurt, të cilët janë tip kordon, që shërbejnë si mjete iniciuese joshpërthyese;

d) ndezësit e sigurt (fitilat e sigurisë), tuba përcjellës, të cilët përbëhen nga një bërthamë e hollë, e grimcuar baruti të zi, rrethuar nga një material tekstil fleksibël, me një ose më shumë veshje mbrojtëse të jashtme, të cilat, kur ndizen, digjen me një shpejtësi të paracaktuar, pa asnjë efekt shpërthyes të

[1] CELEX nr. 32008L0043, "Direktiva e Komisionit 2008/43/KE, "Për ngritjen, sipas direktivës së Këshillit 93/15/KEE, të një sistemi të identifikimit dhe gjurmimit të lëndëve plasëse për përdorim civil" e konsoliduar. OJ L 094, 5.4.2008, p. 8, e amenduar me CELEX nr. 32012L0004 direktivën e Komisionit 2012/4/EU e datës 22 shkurt OJ L 50, 23.2.2012, p. 18.

jashtëm;

dh) kapsollat ndezëse në formë kapaku, të cilat përbëhen nga një mbulesë metalike ose plastike, me sasi të vogël përzierjeje eksplozivi fillestar, lehtësisht të ndezshme me një goditje dhe që shërben si element ndezës në fishekët e armëve të vogla ose në kapsollat ndezëse për mbushje shtytëse.

KREU II
IDENTIFIKIMI I PRODUKTIT

Neni 3
Identifikimi unik

1. Subjektet tregtare, të cilët prodhojnë, importojnë lëndë plasëse për përdorim civil ose montojnë detonatorë, duhet të vendosin në lëndët plasëse dhe në çdo njësi, sado të vogël, paketimi numrin e identifikimit unik (NIU).

Kur një lëndë plasëse u nënshtrohet proceseve të mëtejshme të prodhimit, prodhuesve nuk u kërkohet që të vendosin në lëndën plasëse NIU të ri, përveç rasteve kur identifikimi unik fillestar nuk është më i shënuar, sipas nenit 4, të këtij akti.

2. Vendosja e NIU-t nuk do të aplikohet për rastet kur lënda plasëse prodhohet për qëllime eksporti dhe kur ky numër është vendosur sipas kërkesave të vendit importues, i cili lejon gjurmueshmërinë e lëndës plasëse. Në këtë rast, prodhuesi raporton NIU-n pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) në Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Numri i identifikimit unik përfshin komponentët e përshkruar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij akti dhe pjesë e pandarë e tyre.

4. Çdo vendi prodhimi lëndësh plasëse për përdorim civil në Republikën e Shqipërisë do t'i atribuohet një kod treshifror nga AKSHE-ja.

5. Nëse vendi i prodhimit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe prodhuesi kryen aktivitet në Republikën e Shqipërisë, është vetë prodhuesi që kontakton me AKSHE-n për pajisjen me NIU.

Nëse vendi i prodhimit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe prodhuesi nuk kryen aktivitet në Republikën e Shqipërisë, atëherë është importuesi ai i cili kontakton me AKSHE-në për pajisjen me NIU.

6. Shpërndarësit, të cilët riambalazhojnë lëndët plasëse për përdorim civil, të sigurohen që lëndëve plasëse dhe njësive më të vogla të ambalazhimit t'u vendoset NIU.

Neni 4
Shënjimi dhe ngjitja

Numri i identifikimit unik shënjohet ose ngjitet mirë në çdo njësi, në një mënyrë të tillë që të mos hiqet më dhe të lexohet qartë.

Neni 5
Lëndët plasëse të ambalazhuara dhe lëndët plasëse në thasë

Për lëndët plasëse të ambalazhuara dhe ato në thasë, NIU përbëhet nga një etiketë ngjitëse ose printim/vulosje direkte mbi çdo paketim ose thes. Etiketa vendoset edhe mbi çdo arkë me lëndë plasëse të ambalazhuara.

Përveç kësaj, subjektet tregtare mund të përdorin një etiketë elektronike inerte pasive, që ngjitet mbi çdo ambalazhim ose thes me lëndë plasëse. Etiketa elektronike vendoset edhe mbi çdo arkë me lëndë plasëse të paketuara.

Neni 6
Lëndët plasëse me dy përbërës

Për lëndët plasëse me dy përbërës, NIU përbëhet nga një etiketë ngjitëse ose printim/vulosje direkte mbi njësinë më të vogël të ambalazhimit që përmban dy komponentët.

Neni 7

Detonatorët e thjeshtë

Për detonatorët e thjeshtë, NIU përbëhet nga një etiketë ngjitëse ose printim/vulosje direkte në skeletin e detonatorit. Etiketa vendoset edhe mbi çdo arkë me detonatorë të thjeshtë.

Përveç kësaj, subjektet tregtare mund të përdorin një etiketë elektronike inerte pasive, që ngjitet mbi çdo detonator të thjeshtë. Etiketa elektronike vendoset edhe mbi çdo arkë me detonatorë të thjeshtë.

Neni 8

Detonatorët elektrikë, joelektrikë dhe elektronikë

Për detonatorët elektrikë, joelektrikë dhe elektronikë NIU përbëhet nga një etiketë ngjitëse, e cila vendoset mbi tel ose tub, apo nga një etiketë ngjitëse ose printim/vulosje direkte mbi skeletin e detonatorit. Etiketa vendoset edhe mbi çdo arkë me detonatorë.

Përveç kësaj, subjektet tregtare mund të përdorin një etiketë elektronike inerte pasive që ngjitet mbi çdo detonator. Etiketa elektronike vendoset edhe mbi çdo arkë me detonatorë.

Neni 9

Ndezësit dhe përforcuesit shtytës

Për ndezësit, përveç atyre të përmendur në pikën 2, të nenit 2, të këtij akti, dhe përforcuesit shtytës, NIU përbëhet nga një etiketë ngjitëse ose printim/vulosje direkte mbi këta ndezës dhe përforcues shtytës. Etiketa vendoset edhe mbi çdo arkë me ndezës dhe përforcues shtytës.

Përveç kësaj, subjektet tregtare mund të përdorin një etiketë elektronike inerte pasive, që ngjitet mbi çdo ndezës dhe përforcues shtytës, dhe një etiketë tjetër mbi çdo arkë me ndezës dhe përforcues shtytës.

Neni 10

Fitilat detonant

Për fitilat detonant, NIU përbëhet nga një etiketë ngjitëse ose printim/vulosje direkte mbi bobinë. NIU shenjohet çdo 5 metra, në të dyja anët e mbështjellësit të jashtëm të fitilit ose në shtresën plastike të brendshme, e cila gjendet menjëherë nën fibrat e jashtme të fitilit. Etiketa vendoset edhe mbi çdo arkë të fitilit detonant.

Përveç kësaj, subjektet tregtare mund të përdorin një etiketë elektronike inerte pasive të futur brenda fitilit. Etiketa elektronike vendoset edhe mbi çdo arkë me fitil.

Neni 11

Kutitë dhe cilindrat që përmbajnë lëndë plasëse

Për kutitë dhe cilindrat që përmbajnë lëndë plasëse, NIU përbëhet nga një etiketë ngjitëse ose printim/vulosje direkte mbi kutinë ose cilindrin që përmban lëndën plasëse.

Përveç kësaj, subjektet mund të përdorin një etiketë elektronike inerte pasive, që ngjitet mbi çdo kuti ose cilindër.

Neni 12

Kopje të etiketës origjinale

Subjektet tregtare mund të ngjisin kopje, që mund të hiqen, të etiketës origjinale në lëndët plasëse që do të përdoren nga klientët e tyre. Për të parandaluar keqpërdorimin, këto kopje shënjohen në mënyrë të dukshme si kopje të origjinales.

KREU III

MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE REGJISTRIMI

Neni 13
Mbledhja e të dhënave

1. Subjektet tregtare në fushën e prodhimit, importimit, eksportimit, përdorimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil duhet të krijojnë dhe të mbajnë një sistem për mbledhjen e të dhënave, në lidhje me lëndët plasëse për përdorim civil, duke përfshirë NIU-n e tyre në çdo fazë të posedimit të këtyre mallrave, nga prodhimi, importimi, hedhja në treg për herë të parë dhe deri te përdorimi i fundit i tyre ose përfundimi i ciklit të tyre jetësor.

2. Sistemi i mbledhjes së të dhënave duhet të jetë i tillë që t'u lejojë subjekteve dhe autoriteteve shtetërore gjurmimin e lëndëve plasëse, në mënyrë që poseduesit e lëndëve plasëse të mund të identifikohen në çdo kohë.

3. Subjektet tregtare, që operojnë në fushën e prodhimit, importimit, eksportimit, përdorimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, detyrohen që të ruajnë të dhënat e mbledhura, duke përfshirë NIU-n, për një periudhë 10-vjeçare pas blerjes, shitjes, përdorimit dhe asgjësimit ose, kur dihet, pas përfundimit të ciklit jetësor të lëndës plasëse edhe nëse këto subjekte e kanë ndaluar veprimtarinë e tregtimit.

Neni 14
Detyrimet e subjekteve tregtare

Subjektet tregtare, që operojnë në fushën e prodhimit, importimit, eksportimit, përdorimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil duhet të përmbushin këto detyrime:

1. Të regjistrojnë të gjithë NIU-t e lëndëve plasëse, së bashku me të gjitha informacionet përkatëse, duke përfshirë llojin e lëndës plasëse, shoqërinë ose personin të cilit i jepet në kujdestari;

2. Të regjistrojnë vendndodhjen e çdo lënde plasëse ndërkohë që lënda plasëse është në zotërimin ose kujdestarinë e tyre, derisa ajo të transferohet drejt një subjekti tjetër ose të përdoret;

3. Të testojnë, në intervale të rregullta, sistemin për mbledhjen e të dhënave, me qëllim që të sigurohen që ai të mbetet i vlefshëm dhe të sigurohen për cilësinë e të dhënave të regjistruara;

4. Të ruajnë dhe të mirëmbajnë të dhënat e mbledhura, duke përfshirë NIU-të për periudhën e specifikuar në pikën 3, të nenit 13, të këtij akti;

5. Të mbrojnë të dhënat e mbledhura nga dëmtimi ose shkatërrimi i paqëllimshëm apo keqdashës;

6. T'u japin autoriteteve kompetente (AKSHE-së, Policisë së Shtetit dhe organeve të tjera ligjzbatuese), me kërkesën e tyre, informacione që lidhen me origjinën dhe vendndodhjen e çdo lënde plasëse, në çdo fazë të posedimit të tyre, nga prodhimi, importimi, hedhja në treg për herë të parë dhe deri te përdorimi i fundit i tyre;

7. T'u japin autoriteteve kompetente (AKSHE-së dhe Policisë së Shtetit) emrin dhe të dhënat e kontaktit të një personi që mund të japë informacionin e përshkruar në pikës 5, të këtij neni, edhe jashtë orarit normal të punës.

Për qëllimet e pikës 4, të këtij neni, sipërmarrja, në rastin e lëndëve plasëse të prodhuara ose të importuara përpara datës së hyrjes në fuqi të këtyre rregullave dhe procedurave, duhet të mbajë të dhëna në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm në fuqi.

KREU IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Detyrat e AKSHE-së

AKSHE-ja është organi shtetëror përgjegjës për kontrollin e zbatueshmërisë së dispozitave të këtyre rregullave dhe procedurave nga importuesit dhe prodhuesit e lëndëve plasëse për përdorim civil.

AKSHE-ja ushtron kontrolle periodike te subjektet tregtare, për verifikim e mbajtjes së rregullt të sistemit të mbledhjes së të dhënave.

Neni 16

Sanksione

Në rast të mosrespektimit të detyrimeve të përcaktuara në nenet 13 e 14, të këtij akti, komisioni i dhënies së licencave për import, eksport, prodhim lëndësh plasëse dhe piroteknike për përdorim civil merr vendim për pezullimin e licencës së importit, eksportit dhe të prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, deri në marrjen e masave nga subjekti tregtar për rregullim e gjendjes që çoi në marrjen e vendimit për pezullimin e licencës.

Në rast se subjekti tregtar nuk merr masa brenda një periudhe 3-mujore, atëherë komisioni i dhënies së licencave për import, eksport, prodhim lëndësh plasëse dhe piroteknike për përdorim civil merr vendim për heqjen e licencës së importit, eksportit dhe të prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.

SHTOJCA NR. 1

Numri i identifikimit unik përfshin:

1. Një pjesë të lexueshme të identifikuesit, e cila përmban:

a) emrin e prodhuesit;

b) një kod alfanumerik, që përmban:

i) dy shkronja që identifikojnë shtetin (vendin e prodhimit ose importit);

ii) tri shifra që identifikojnë emrin e vendit të prodhimit (të caktuara me urdhër të kryetarit të AKSHE-së);

iii) kodin unik të produktit dhe informacionet logjistike të përgatitura nga prodhuesi.

2. Një identifikues elektronik të lexueshëm në formatin e barkodit dhe/ose kodit të matricës, që lidhet drejtpërsëdrejti me kodin alfanumerik të identifikimit.

Shembull:

3. Për artikujt që janë shumë të vegjël për t'u ngjitur kodin unik të produktit dhe informacionin logjistik të përgatitur nga prodhuesi, informacioni në zbatim të nënparagrafëve "i" e "ii", të shkronjës "b", të pikës 1, të kësaj shtojce, konsiderohet i mjaftueshëm.

Për artikujt që janë tepër të vegjël e ku nuk mund të ngjitet as informacioni sipas nënparagrafëve "i" e "ii", të shkronjës "b", të pikës 1, të kësaj shtojce, ose kur, për shkak të formës ose dizajnit të tyre, është teknikisht e pamundur të ngjitet identifikuesi unik, atëherë identifikuesi unik ngjitet në njësinë më të vogël të ambalazhimit. Njësia më e vogël e ambalazhimit mbyllet me vulë/plumbçe/etiketë ndërmjetëse.

Mbi çdo detonator të zakonshëm ose përforcues shtytës që bën pjesë në përjashtimin e përcaktuar në paragrafin e dytë të kësaj pike, informacioni sipas nënparagrafëve "i" e "ii", të shkronjës "b", të pikës 1, shënohet mbi njësinë më të vogël të ambalazhimit, në mënyrë të qëndrueshme dhe qartësisht të lexueshme. Në njësinë më të vogël të ambalazhimit shënohet edhe numri i detonatorëve të zakonshëm dhe i përforcuesve shtytës që ajo përmban.

Mbi çdo fitil detonues, që bën pjesë në përjashtimin e përcaktuar në paragrafin e dytë të kësaj pike, NIU shënohet mbi bobinë dhe, kur është e mundur, mbi njësinë më të vogël të ambalazhimit.